REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL

DREJTORIA E SHËRBIMEVE JURIDIKE,PROKURIMEVE DHE ZBATIMIT TE KONTRATAVE

SEKTORI JURIDIK DHE PROKURIMEVE

PROJEKT-VENDIM

Nr. 13/1, Date 20/02/2025

"PER KALIMIN NË PRONËSI TË TROJEVE TË DHËNA PËR QËLLIME NDËRTIMI NGA BASHKITË, ISH KOMUNAT DHE ISH KËSHILLAT E RRETHEVE PAS DATËS 10.08.1991 DERI NË HYRJEN NË FUQI TË LIGJIT 24/2012 "PËR TË DREJTËN E PRIVATIZIMIT TË TRUALLIT SHTETEROR NË PËRDORIM DHE PËR TAKSËN MBI TË DREJTËN E PËRDORIMIT TË TIJ" DHE PËR AUTORIZIMIN E KRYETARIT TË BASHKISË DEVOLL OSE TË AUTORIZUARIT LIGJOR TË TIJ PËR LIDHJEN E KONTRATËS PËRPARA NOTERIT PËR SHITJEN E TROJEVE TË DHËNA PËR NDËRTIM"

Bazuar ne: - Ligjin Nr. 139/2015 date 17.12.2015 "Per Veteqeverisjen Vendore" i ndryshuar, Neni 8 Neni 9 pika 1.2 " Të drejtën dhe përgjegjësinë e pronësisë: a) njësitë e vetëqeverisjes vendore ushtrojnë të drejtën e pronësisë, ato fitojnë shesin dhe japin në përdorim pronën e paluajtshme ose të luajtshme të tyre...."c) e drejta e pronësisë ushtrohet nga këshilli përkatës i cili nuk mund t'ia delegojë ushrtrimin e kësaj të drejte askujt tjetër"
Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 329 datë 22.05.2019 " Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës të Bashkive me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës për rregjistrimin e trojeve të dhëna për ndërtim nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe për rregullimin e marrëdhënieve juridike të pronësisë mbi këto troje për efekt regjistrimi" Pika 6, pika 9.1 pika 11.

PROPOZOJ:

1.Në zbatim të VKM Nr. 329 datë 22.05.2019 "Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës të Bashkive me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës për rregjistrimin e trojeve të dhëna për ndërtim nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe për rregullimin e marrëdhënieve juridike të pronësisë mbi këto troje për efekt regjistrimi" **të bëhet plotësimi i dokumentacionit dhe kalimi në pronësi i trojeve të dhëna për ndërtim nga njësitë e vetëqeverisjes vendore** pas datës 10.8.1991 deri në hyrjen në fuqi të Ligjit 24/2012 " Për disa ndryshime në ligjin 10270 datë 22.04.2001 për të drejtën e privatizimit të truallit shteteror në përdorim dhe për taksën mbi të drejtën e përdorimit të tij" për subjektet të cilët plotësojnë kriteret dhe dokumentacionin e kërkuar nga vendimi Nr. 329 datë 22.05.2019 sipas tabeles te mëposhtme.

Adresa: Bashkia Devoll, Lagja Nr. 1, Rr. 24 Tetori Nr. 9, Tel & Fax +35581123815-22288, e-mail: bashkiadevoll@gmail.com

Nr.	Emer /Mbiemer	Vendimi i Organit Vendor	Shlyerja e pageses
1	Ali Bakalli	VKB 210 Dt. 05.07.1993	JO

2. Të autorizohet Kryetari i Bashkisë Devoll për lidhjen e kontrates para noterit sipas përcaktimeve të VKM-së Nr. 329.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve në nenin 55 të Ligjit Nr. 139/2015 " Për vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar

Konceptoi dhe konfirmoi bazen ligjore:
Pergjegjes i Sektorit Juridik dhe Prokurimeve
Eriksela Avdo

KRYETARI I BASHKISE

EDUARD DURO

Adresa: Bashkia Devoll, Lagja Nr. 1, Rr. 24 Tetori Nr. 9, Tel & Fax +35581123815-22288, e-mail: bashkiadevoll@gmail.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E SHËRBIMEVE JURIDIKE,PROKURIMEVE DHE ZBATIMIT TE KONTRATAVE
SEKTORI JURIDIK DHE PROKURIMEVE

Nr. 712 **Prot** **Date** 18/07/**2025**

RELACION

PËR

PROJEKT VENDIMIN

"PER KALIMIN NË PRONËSI TË TROJEVE TË DHËNA PËR QËLLIME NDËRTIMI NGA BASHKITË, ISH KOMUNAT DHE ISH KËSHILLAT E RRETHEVE PAS DATËS 10.08.1991 DERI NË HYRJEN NË FUQI TË LIGJIT 24/2012 "PËR TË DREJTËN E PRIVATIZIMIT TË TRUALLIT SHTETEROR NË PËRDORIM DHE PËR TAKSËN MBI TË DREJTËN E PËRDORIMIT TË TIJ" DHE PËR AUTORIZIMIN E KRYETARIT TË BASHKISË DEVOLL OSE TË AUTORIZUARIT LIGJOR TË TIJ PËR LIDHJEN E KONTRATËS PËRPARA NOTERIT PËR SHITJEN E TROJEVE TË DHËNA PËR NDËRTIM"

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak Devoll!

Pas viteve 1991 qytetarët e Bashkisë Devoll kanë përfituar truall të dhënë për qëllime ndërtimi **nga Bashkitë, ish-komunat dhe ish këshillat e rretheve (në vijim të quajtuar organet vendore).** Për vite me rradhë qytetarët nuk kanë mundur të regjistrojnë truallin e tyre për shkak të mungesës së legjislacionit dhe të dokumentacionit që përmbante dosja e tyre. Kjo sillte cënim të një prej të drejtave themelore të individit të drejtës së pronësisë dhe mosgëzim të qetë të pasurisë së tyre të paluajtshme. Disa nga përfituesit e ketyre trojeve për ndërtim kanë arritur të regjistrojnë pranë Ish- Zyrës Vendore te Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Devoll ndërtesat e ndërtuara mbi truallin e dhënë për ndërtim ndërsa disa të tjerë akoma dhe sot për shkak të mungesës të legjislacionit nuk kanë mundur të regjistrojnë as trullin dhe as objektin e ndërtuar mbi të.

Me daljen e Vendimit Nr. 329 datë 22.05.2019 " Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës të Bashkive me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës për regjistrimin e trojeve të dhëna për

ndërtim nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe për rregullimin e marrëdhënieve juridike të pronësisë mbi këto troje për efekt regjistrimi" synohet qe subjektet përfitues të trojeve të dhëna për ndërtim nga organet vendore të mund të regjistrojnë më në fund pasuritë e tyre të paluajtshme truallin e dhënë për ndërtim dhe objektin e ndërtuar mbi të(për subjektet të cilët ende nuk kanë regjistruar ndërtesën).

Pika 2 e Vendimit parashikon se objekt i vendimit janë tokat e dhëna për qëllime ndërtimi **nga Bashkitë, Ish-Komunat dhe Ish-Këshillat e Rretheve(në vijim të quajtura organe vendore)** pas datës 10.8.1991 deri në hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 24/2012, " Për disa ndryshime në ligjihn Nr. 24/2012 " Për disa ndryshime në ligjin nr. 10270, datë 22.4.2010, "Për të drejtën e privatizimit të truallit shtetëror në përdorim dhe për taksën mbi të drejtën e përdorimit të tij".

Sipas pikës 5 të Vendimit subjekti i interesuar mund të paraqesë kërkesë:

a) Pranë drejtorisë Vendore të ASHK-së nëse pasuria ka qënë e regjistruar më parë.
b) Pranë bashkisë kompetente, në rastet sipas pikës 11 të vendimit e cila parashikon se: Subjekti që nuk zotëron dokumentacionin e plotë të përcaktuar në pikën 6 të këtij vendimi, por që ka të paktën Vendimin e Këshillit të organit Vendor për dhënien e tokës për ndërtim, ka të drejtë ti paraqesë kërkesë Bashkisë Përkatëse për kryerjen e procedurës së kalimit të pronësisë. Bashkia procedon me plotësimin e documentacionit dhe dërgimin e tij për regjistrim sipas pikës 9.1 te vendimit.

Pika 9.1 e Vendimit parashikon se nese Bashkia konstaton se per pasurinë dokumentacioni nuk është i **plotë, por egziston të paktën vendimi I Këshillit të organit vendor për dhënien e tokës për ndërtim** ajo procedon duke I kërkuar subjektit përfitues të shlyejë pjesën e mbëtur të cmimit të shitjes, të përcaktuar në aktin e kalimit të pronësisë dhe/ ose duke **thirur subjektin përfitues për lidhjen e kontratës noteriale për kalimin e pronësisë mbi tokën nëse ajo** nuk është lidhur më parë, pasi të jetë shlyer vlera e plotë e cmimit.

Pra shkurtimisht Vendimi parashikon se subjektët perfitues mund të regjistrojnë pasurinë e tyre të dhënë për ndërtim pasi janë pajisur të paktën me Vendimin e Organit Vendor për dhënien e trullit të ndërtimit, të kenë shlyer vlerën e truallit ose nese nuk e kane shlyer ate më pare, të shlyejnë vlerën e trullit sipas vlerës së llogaritur nga Komisioni i ngritur pranë Bashkisë Devoll për zbatimin e vendimit Nr. 329 datë 22.05.2019.

Pikërisht në zbatim të Vendimit Komisioni i ngritur me Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë Nr. 204 datë 24.09.2019 mori në shqyrtim 1(nje) dosje tjeter te apliuesit të dorezuar nga Subjektet perfitues pranë Bashkisë Devoll per të vlerësuar dhe konstatuar nëse aplikuesi permbush kriteret e përcaktuar ne piken 6 të Vendimit.

Nr.	Emer /Mbiemer	Vendimi i Organit Vendor	Shlyerja e pageses

1	Ali Bakalli	VKB 210 Dt. 05.07.1993	JO

Ne përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit Komisioni arriti në përfundimin se subjekti i mësipërm ka Vendimin e organit Vendor për dhënien e sheshit për ndërtim duke plotësuar në këtë mënyrë kushtin kryesor dhe thelbësor për regjestrimin e tyre të pasurisë truall.

Komisioni i zbatimit të Vendimit Nr. 329 datë 22.05.2019 do të vazhdojë me llogaritjen e cmimit të turallit sipas përcaktimit të pikës 9.1 të vendimit i cili përcakton se: "Cmimi I shitjes do të jetë sipas vlerës së referencës në momentin e miratimit të Vendimit të Këshhilllit nga organi vendor për dhenien e tokës për ndërtim"

Pas llogaritjes se cmimit të truallit dhe pas vendimit të Këshillit Bashkiak për autorizimin e kryetarit të Bashkisë ose të Autorizuarit prej tij për lidhjen e kontratës, Bashkia Devoll do te vazhdojë me nënshkrimin e kontratës përpara noterit dhe dergimin e dosjeve te aplikantit ne Agjencinë Shtetërore e Kadastrës Devoll për regjistrimin e pasurive truall të dhëna për ndërtim.

Duke ju falenderuar per bashkepunimin!

Pergjegjes i Sektorit Juridik dhe Prokurimeve
Eriksela Avdo

KRYETARI I BASHKISE

EDUARD DURO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DEVOLL

Adresa: Bashkia Devoll, Lagja Nr. 1, Rr. 24 Tetori Nr. 9, Tel & Fax +35581123815-22288, e-mail: bashkiadevoll@gmail.com

V E N D I M

Nr 210 Më 5.7.1993

Këshilli popullor i rrethit Pogradec me mbledhjen
e tij të datës 5.7.1993 mbasi shqyrtoi [illegible]
[illegible] [illegible]
[illegible]

V E N D O S

[illegible]

1. [illegible]
2. [illegible]
3. [illegible]
4. [illegible]
5. [illegible]
6. [illegible]
7. [illegible]
8. [illegible]
9. [illegible]
10. [illegible]

[illegible]

[illegible]

[

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTESISE
IPOTEKA KORCE

VERTETIM PRONE IE

N regjistrua ne nr 99/7 dt 2.9.1994 (dy mbtabu
nj mij mentegind e nentodhjet ekater) te regjistrave te
pronesise.

REPUBLIKA E IPOTEKA
LILJANA BAKU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
Ipoteka Korcë

Korcë, më 19

Vertetim negativ pronesise

Nga kqyerja e regjistrave të pronesise qe disponon kjo zyre
rezulton se ne emer të nuk figuron
e regjistruar nje shtëpi banimi ne
me kufij:
Lindje perendim
Jug Veri

NENPUNESJA E IPOTEKES
(Liljana Baku)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË KORCË
NOTERE PUBLIKE
NR. 443 Rep.
Nr. 183 Kol.

KONTRATË SHIT-BLERJE

Sot me daten 1.9.1994 (një shtator njemijë e nëntëqind e nën-
dhjet e kater), diten e ENJTE, para meje ZHULIETA ILIA MANO, me dëftyren e
teres u paraqiten personalisht palet:

SHITES: SEKSIONI I FINANCES RRETHIT BILISHT, përfaqesuar nga
BEXHET ALICKOLLI, banues ne Bilisht, madhor, i afte për te kryer ve-
jurdike, i njohur prej meje personalisht.

BLERES: ALI BAKALLI, i biri i Idealit, me datlindje 1966, banues
ne Bilisht, madhor, i afte për te kryer veprime juridike, i pe njohur
prej meje për identitetin e te cilit u sigurova me ane te leter-
timit përkates.

Palet kerkuan redaktimin e kesaj kontrate shitje ne përmbajt-
qo vijon:

Përfaqesuesi i pales shitese deklaron se ka ne administrim
truall te ndodhur ne qytetin e Bilishtit te përbere nga 380 m2, e
kufizohet: ne veri me rrugen kryesore, ne juge me Valent Kordelli,
ne lindje me rruge dhe ne perendim me Vlli Kollçinaku, pronesia e
cilës bazohet ne dokumentat e ëgjensise se privatizimit (seksionit
finances Bilisht.

Përfaqesuesi i pales shitese deklaron se eshte plotesisht dhe
kord me truallin e përshkuar me lart te blere Ali Bakallë përmbi
vlerës së sipërme, vlere e cila eshte shlyer jashte kesaj gyre dhe
me ketij veprimi ai behet pronar i ketij trualli, [illegible]
Kesaj kontrate shit-blerje i bashkangjiten dhe ketë dokumen-
Një akt vleresimi, nje kontrate shitje si dhe nje skice
dhe nje mandat pagese.


A sipër lexohet kjo kontrate shit-blerje me përmbajtjen e
te cilës palet jane plotesisht dakord dhe e nenshkruan ate ne
para meje.

P A L E T

SHITES: SEKSIONI I FINANCES RRETHIT BILISHT
PËRFAQ. BEXHET ALICKOLLI

BLERES: ALI BAKALLI
Ali Bakalli

N O T E R E
ZHULIETA ILIA MANO



27

2.10.1993

Shtepi Baleni


Ali Barcalli

inp. Ilir Hide

Fyra e lirë në Berat

PLAN VENDOSJE

SH-1:500



Qytetari z. Ali Bakalli
Objekti Shtepi Banimi dhe oborr per nevoje PRONE.
Adresa Q. Bilisht

TE DHENA TEKNIKE

1. Siperfaqe shtepie 12.50 x 8.50 = 106.00 m²
2. Siperfaqe oborri 20x19 = 381-106 = 275
   Gjithsej 381 m²

Emertimi i Nderteses Shtepi Banimi
Kostruksioni Me Gure e Tulla
Numuri Kateve 1 (nje)
Lartesi Kati 4.50
Kubatura 106 x 4.50 = 477 m³

KUFIZIMET

1. Veriu Rruga Kryesore
2. Jugu Vafent Kordalli
3. Lindje Rruge
4. Perendimi Ylli Kollçinaku.

PUNOI

Topograf Engjell Mazelli

Vërtetohet firma
Sekretar ... Banisë
(Audrey Spaso)